



AUTORITETI KONTRAKTOR:
Autoriteti Rrugor Shqiptar

RAPORT TEKNIK

(Faza, Ndërhyrje emergjente)

Titulli Projektit:

"NDËRHYRJE EMERGJENTE PËR MBROJTJEN E PILAVE NË
URËN E MILOTIT"



AUTORITETI KONTRAKTOR:

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Nr.33, Tiranë

Telefon: 04 222 3600

Email: info@arrsh.gov.al



KONSULENT :

Universiteti Politeknik i Tiranës

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"

Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë 1000

Telefon: +355 4 222 7914

Email: info@upt.al



Tiranë, Gusht 2025



AUTORITETI KONTRAKTOR:
Autoriteti Rrugor Shqiptar

PËRMBAJTJA E KAPITUJVE DHE NËN KAPITUJVE

1	Studim mbi ndërhyrjen emergjente në Urën e Milotit.....	1
1.1	Përshkrimi i përgjithshëm	1
1.2	Qëllimi i raportit.....	2
1.3	Inspektimi dhe gjetjet.....	2
1.3.1	Të përgjithshme	2
1.3.2	Gjetjet	2
1.3.3	Problematikat e vërejtura	5
1.4	Ndërhyrjet e propozuara	5
1.4.1	Të përgjithshme	5
1.4.2	Filozofia e projektimit	5
1.4.3	Punimet e parashikuara	6
1.5	Kostoja paraprake e realizimit të ndërhyrjeve.....	7
2	Materialet Referuese	7

1 Studim mbi ndërhyrjen emergjente në Urën e Milotit

1.1 Përshkrimi i përgjithshëm

Ura e Milotit ndodhet në aksin rrugor Milot Lezhë mbi lumin Mat, në rrugën Kombëtare Milot Lezhë, SH1.

Projekti për ndërtimin e urës ka datën 24.04.1979 hartuar nga Instituti i Projektmeve Nr. 2 dhe ka qënë pjesë e Projektit “Hekurudha Laç – Shkodër - Kufi” (Urë hekurudhore dhe Automobilistike mbi lumin Mat)

Ura ka 33 hapësira drite (33x23.6) dhe gjatësi totale L=781m. Nënstruktura e saj është prej betoni. Themelet janë me pilota të ngulura prej betoni të armuar me diametër 40cm ¹




Figura 1 Ura e Milotit (Profili Gjatësor i urës Automobilistike dhe Hekurudhore_ - (Dokument i Fondit AQTN)



Figura 2 Foto e përgjithshme e urës nga vizita në vend

¹ Shiko projektin e urës Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit (AQTN)

1.2 Qëllimi i raportit

Bazuar në shkresën e datës 31-Korrik 2025, Nr. 5905/2 prot. “Mbi hartimin e projekti provizor për urën e vjetër auto-hekurudhore të Matit”, nëpërmjet këtij raporti grupi i ekspertëve synon:

Hartimi i projektit për ndërhyrje emergjente në mbrojtjen e themeleve nga gërryerjet e përgjithshme dhe lokale në urën automobilistike – hekurudhore, mbi lumin Mat me qëllim hapjen e saj për trafikun rrugor.

1.3 Inspektimi dhe gjetjet

1.3.1 Të përgjithshme

Inspektimi i Urës u krye në datën 16 Korrik 2025, nga specialistët e konsulentit. Gjatë këtij inspektimi u realizuan matjet në vend, u bënë foto për të gjithë elementët e urës. Investigimi u krye edhe më pas u bë grumbullimi i materialeve nga AQTN. Në paragrafin e mëposhtëm jepet një përshkrim i detajuar i urës që do të studiohet në këtë akt ekspertizë.

1.3.2 Gjetjet

Të dhënat e përgjithshme të urës po i paraqesim në tabelën e mëposhtme

Të dhënat:	Rezultatet
<i>Vendndodhja e urës:</i>	Segmenti rrugor SH1
<i>Tipi i urës</i>	Ura është urë Hekurudhore dhe Automobilistike me themele të përbashkëta
<i>Koordinatat e strukturës:</i>	Sistemi i koordinatave: UTM (Universal Transverse Mercator) Zona: 34T, 392185.54m E, 4615807.11 m N
<i>Tipi i strukturës:</i>	Ura ka mbistrukturë me trarë beton arme me seksion në formë “T” të parapërgatitur me gjatësi 23.6m, dhe fuga 7cm. Mbështetjet janë prej betoni M-300, me dy kolona rrethore d=90cm. Themelet janë realizuar kryesisht me pilota të ngulura, prej betoni të centrifuguar, M- 300, , D=40cm l=10-12m.
<i>Gjatësia e përgjithshme:</i>	781m
<i>Gjerësia e strukturës:</i>	7.0m +2x1m trotuar
<i>Numri i hapësirave:</i>	33
<i>Numri i vijave të kalimit:</i>	2
<i>Gjerësia e kalimit:</i>	7m
<i>Gjerësia e trotuareve:</i>	2x1.0m
<i>Sistem kufizues anësorë:</i>	Parmakë çeliku.
<i>Viti i ndërtimit të urës:</i>	Rreth viteve 1980-1981
<i>Standardi i projektimit</i>	Ura është projektuar për ngarkesën N-18-K80 ref KTP-21-23-1978
<i>Data e hetimit :</i>	16 Korrik 2025

Tabela 1 Të dhëna e përgjithshme

Ura e Milotit mbi lumin Mat

MINISTRIA E NDERTIMIT INSTITUTI STUDIMEVE PROJEKTIVEVE NR.2		NR. ARKIVES SHKALLA 1:100 FAZA PROJ. ZBATIM
Vepra: HEKURUDHA LAÇ-SHIKODER-KUFI URE HEKURUDHORE DHE AUTOMOBILISTIKE MBI LUMIN MAT.		DREJTORI M. DEMIRI SHEFI SEKTOR P. GEREPI PROJEKTUESI M. HOSKO PROJEKTUESI P. BEO M. PATOZI F. BELI G. ADEMI BHALILIU
Emërtimi: Kallëpet e pilave NR.29 e NR.30 dhe ballit nga Miloti		PERPUNUESI T. KABA PREVENTIVUE G. JANO H. HOSKO K. TEJNIK J. JOST
Porositësi	Ministria e Komunikacioneve	DATA 28-4-79 DATO 9 R3-03

Figura 3 Foto mbi të dhënat e projektuesit



Figura 4 Foto e urës nga vizita në vend




Figura 5 Seksioni tërthor dhe mbështetja e mesit tip (Projekti i urës AQTN)




Figura 6 Gërryerjet e përgjithshme dhe lokale në themele




Figura 7 Gërryerjet e përgjithshme dhe lokale në themele

1.3.3 Problematikat e vërejtura

Rezultatet kryesore që lidhen me problematikat e vërejtura gjatë investigimit në vend të themeleve të urës janë :

1. Ndër problematikat kryesore të vërejtura është problemi i themeleve, të cilat pothuaj kanë dalë në sipërfaqe, për shkak të gërryerjes së përgjithshme të shtratit të lumit. (shiko fotot).
2. Thellësia mesatare e gërryerjes së përgjithshme dhe lokale shkon (3÷5)m.
3. Vazhdimi i marrjes së zhavorrit në mënyrë të pa kontrolluar në lum është shkak kryesor i kësaj situatë, fenomen që shfaqet edhe në urat e ndërtuara së fundmi mbi këtë lumë.

1.4 Ndërrhyrjet e propozuara

1.4.1 Të përgjithshme

Lidhur me hartimin mënyrës së ndërrhyrjeve emergjente në këtë urë më poshtë po rendisim disa nga elementet që kemi marrë në konsideratë:

- Ura ka një jetëgjatësi prej më afro se 50 vjet, pra është në mes të jetëgjatësisë së sajë projektuese.
- Gërryerja e përgjithshme e cila për këto 50 vjet kap shifrën nga 3 deri në 5m.
- Shfrytëzimi i pa kontrolluar i shtratit të llumit
- Gjetjet e treguara më sipër.

1.4.2 Filozofia e projektimit

Nisur nga sa më sipër gjykojmë se themelet e Urës janë në një gjendje tej të dëmtuara. Për këtë sugjerojmë se Urës si masë emergjente duhet ti bëhen punimet sipas përshkrimeve të mëposhtme për të siguruar një jetëgjatësi të sajë me kufizimin e ngarkesave siç ajo është sot për një periudhë deri në (5÷10)vjet.

1.4.3 Punimet e parashikuara

Ndër punimet e parashikuara që të kryhen janë :

1. Pastrimi i zonës përreth, pilotave (32 pilave) dhe nivelimi i shtratit përreth tyre,
2. Betonimi i pilotave të themeleve në një lartësi (1.5÷2.5)m duke gjykuar sipas rastit (mbrojtjen e pilotave të dëmtuara dhe thellësisë së gërryerjes).
3. Përforcimi dhe mbrojtja e themelit të pilës dhe ballit nga gërryerjet lokale nëpërmjet krijimi i një qilimi me blloqe të lidhura gabioni siç tregohet në projekt




Figura 8 Ndërhyrjet në mbrojtjen e themeleve




Figura 9 Ilustrimi 3D i gjendjes pas ndërhyrjes strukturore të pilës tip.

1.5 Kostoja paraprake e realizimit të ndërhyrjeve

Duke u bazuar në investigimet në vend, duke parë dhe gjendjen ekzistuese që ka ura, bazuar edhe në ndërhyrjet që do të bëhen vlera paraprake punimeve është: **129,109,584.14** lekë me t.v.sh

2 Materialet Referuese

Vëllimi 5: Urat dhe Tunelet, Pjesa I – Urat

Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit (AQTN)

KTP - Kushtet Teknike të Projektimit Shqiptare

Eurocode – Kushtet Teknike të Projektimit Evropiane

Eurocode 0 (EN 1990) – Bazat e projektimit strukturorë

Eurocode 1 (EN 1991) – Veprimet në struktura

Eurocode 2 (EN 1992) – Projektimi i strukturave prej betoni